

GJENDJA E EKONOMISË SHQIPTARE NË TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2001

FJALA E GUVERNATORIT,

Tremujori i parë i vitit 2001 pritej të ishte kompleks për nga vetë zhvillimet e fundvitit 2000. Dilema kryesore qëndronte në faktin nëse do të kishim një vazhdimësi të fenomeneve të evidentuara sidomos në muajin dhjetor 2000, apo treguesit do të ktheheshin përsëri në shtegun e tyre historik, duke i dhënë fund paqartësive të momentit. Në realitet u vërtetua skenari i dytë, gjë që tregoi se Banka e Shqipërisë kishte të drejtë kur "kërcimin" e inflacionit në muajin dhjetor e vlerësoi si një spekulim me intensitet të lartë. Ndoshta vetë struktura e ekonomisë bëri që efektet negative të krizës energjitike dhe asaj të çmimeve të naftës të zbeheshin ndjeshëm në muajt e parë të vitit 2001. Megjithatë, në hartimin e programit monetar për vitin 2001, Banka e Shqipërisë jo vetëm që ka pasur në vëmendje zhvillimet e sipërpërmendura por, nga ana tjetër, nuk ka lënë jashtë konsideratës së saj dhe zhvillimet ekonomike dhe politike që po karakterizojnë pjesën e parë të vitit 2001.

Duke u kthyer shkurtimisht në arritjet ekonomike të tremujorit të parë, në fillim do të doja të evidentoja faktin që fundi i marsit shënoi përfundimin e një periudhe tjetër të suksesshme në adresë të ruajtjes dhe të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit. Inflacioni, deficitit buxhetor, objektivat sasiorë të programit monetar, pozicioni i jashtëm i vendit, kursi i këmbimit etj., rezultuan në kufijtë e programuar, ndërkohë që edhe procesi i privatizimit njohu përsëri zhvillime të suksesshme.

Duke u ndalur në mënyrë më specifike në zhvillimet monetare dhe tregjet në përgjithësi, me lejoni t'i anashkaloj aspektet sasiorë të treguesve monetarë për t'i vënë një theks më të veçantë zhvillimeve të tregut të parasë dhe përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për rritjen e efikasitetit të këtij tregu.

Siç mund të jeni në dijeni nga prononcimet më të hershme të Bankës së Shqipërisë, përqindja e interesit në përgjithësi ka regjistruar një kurbë në rënie, e cila, përveç të tjerash, pasqyron dhe politikën e ndjekura nga Banka në të kaluarën. Kjo tendencë në rënie ka qenë e pranishme kudo, përfshirë dhe normat e kredisë në lekë, ndërkohë që kërkesa e ekonomisë për monedhën shqiptare gjatë gjithë muajve të fundit ka qenë e dobët.

Kjo situatë e ka detyruar Bankën e Shqipërisë që të thithë likuiditetin e tepërt në sistem me anë të marrëveshjeve të riblerjes, sidomos në kohët e fundit, pa bërë dallim për shumatat që ofrohen kundrejt çmimit fiks të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

Sinjali kryesor që i është përçuar tregut deri tani, ka qenë ai i mbajtjes së një pozicioni neutral, në pritje të uljes së normave të interesit. Duke reflektuar me kujdes ndaj zhvillimeve aktuale, sidomos ndaj atyre të ditëve të fundit, Banka e Shqipërisë mendon se ka ardhur koha për të adoptuar një qëndrim të ri, pak më të ndryshëm se aktuali.

Ky qëndrim duhet të kuptohet si mbarim i periudhës së neutralitetit dhe fillim i një politike më vëzhguese e vepruese në drejtim të normave të interesit.

Kjo lëvizje vlerësohet e domosdoshme dhe do t'i krijojë Bankës së Shqipërisë hapësirat e nevojshme për të vlerësuar dhe gjykuar më drejt zhvillimet e pritshme të inflacionit në muajin qershor, problemet që mund të karakterizojnë prodhimin e brendshëm bujqësor, shpenzimet buxhetore në muajt e fundit, një rritje të kërkesës për para nga ana e Qeverisë në kushtet e përdorimit të të ardhurave të siguruar nga privatizimi, rëndimin e situatës në rajon etj.

Megjithatë, duhet theksuar se kjo lëvizje është thjesht një lloj sinjali dhe nuk duhet konsideruar si një ndryshim i politikës monetare. Do t'i mbetet zhvillimeve në të ardhmen për të gjykuar dhe vendosur nëse është i domosdoshëm apo jo një ndryshim në përqindjen e interesit.

Shkëlqim Cani

Guvernator

I. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2001.

Zhvillimet e përjetuara gjatë periudhës 1998-2000 si dhe problemet që e shoqëruan atë, ndikuan në përcaktimin e objektivave për vitin 2001. Synimi kryesor është që, gjatë vitit 2001, të sigurohet konsolidimi i treguesve makroekonomikë. Respektimi i objektivave të programuara në tre vitet e fundit, sidomos gjatë vitit 2000, krijonë premisa që edhe objektivat sasiorë të përcaktuara për vitin në vazhdim të jenë ambiciozë dhe të arritshëm.

Tipari më i spikatur gjatë vitit 2000 ka qenë intensifikimi i procesit të privatizimit të sektorëve strategjikë dhe sidomos privatizimi i disa objekteve të rëndësishëm, përfshirë përfundimin e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare. Efektet pozitive të këtij fenomeni u vërejtën në më shumë të ardhura për buxhetin e shtetit, në krijimin e premisave për rritje të investimeve dhe të punësimit dhe sidomos në përmirësimin e klimës për investitorët e huaj. Nga ana tjetër, tremujori i fundit i vitit 2000 u ballafaqua me krizën energjitike të shkaktuar nga ndërprerjet në furnizimin me energji si edhe nga rritja e përkohshme e çmimit të karburanteve në tregjet ndërkombëtare, të cilat, ndonëse nuk rrezikuan arritjen e objektivave për këtë vit, ulën disi optimizmin për vitin 2001.

Objektivat për zhvillimin e ekonomisë gjatë vitit 2001 janë parashikuar si më poshtë:

- rritja reale ekonomike e vendit mendohet të arrijë nivelin 7.3 për qind;
- inflacioni deri në fund të vitit parashikohet të luhatet nga 2 deri në 4 për qind, nivele që njëherësh sigurojnë stabilitetin e çmimeve dhe mbështesin rritjen ekonomike të parashikuar;
- deficitin e përgjithshëm buxhetor parashikohet të arrijë nivelin 9.1 për qind të PBB-së; pjesa e financuar nga burime të brendshme parashikohet të arrijë shifrën 2.9 për qind (pa përfshirë të ardhurat nga privatizimi);
- kufiri për rezervat valutore ndërkombëtare është parashikuar të jetë i mjaftueshëm për të përballuar 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË BOTËRORE.

Rritja e ekonomisë botërore për vitin 2001 ishte parashikuar¹ në 3.4 për qind, përkundrajt një rritjeje prej 4.8 për qind të shënuar gjatë vitit 2000. Kjo rënie i dedikohet rënies së ciklit të biznesit në ekonominë e përparuar, ku rritja pritet të jetë 2.2 për qind (nga 4.1 për qind në vitin 2000), me rënien më të madhe të parashikuar për ekonominë amerikane.

Në perspektivat e një ekonomie në rënie, Rezerva Federale reduktoi normat e interesave me 0.5 pikë në maj 2001, për herë të pestë që nga fillimi i vitit, duke bërë që ky tregues të arrijë në 4 për qind. Me synim rritjen e shpenzimeve të konsumit dhe të kërkesës, përveç reduktimit të normave të interesave, administrata amerikane është në shqyrtim të miratimit të një pakete të reduktimit të taksave, efektet e të cilës janë më të menjëhershme se ndikimi i normave të interesave. PBB gjatë tremujorit të parë u rrit me 2.5 për qind në nivel vjetor. Indeksi i prodhimit industrial gjatë muajt prill ra me 0.3 për qind, norma e papunësisë gjatë tremujorit të parë u rrit me 0.4 për qind, duke e çuar normën e papunësisë në 4.5 për qind në fund të muajt prill 2001. Megjithëse ekonomia mbetet e dobët, janë vënë re shenjat e rritjes së inflacionit. Gjatë muajt prill 2001, niveli vjetor i çmimeve u ngjiti në 3.3 për qind.

Ekonomia gjermane, që llogaritet në një të tretën e gjithë zonës së euros, gjatë tremujorit të parë të vitit shënoi një rënie të aktivitetit ekonomik. Lajmi më zhgënjyes ishte fakti që rritja reale e PBB-së për tremujorin e parë u rrit me 0.4 për qind kundrejt tremujorit paraardhës². Indeksi i klimës së biznesit në Gjermani, në muajt mars 2001, ra në 92.5 për qind, që shënon nivelin më të ulët që nga maji i vitit të kaluar. Kjo ishte kryesisht rrjedhojë e rënies së aktivitetit të ndërtimit

¹ World Economic Outlook, IMF, March 14, 2001.

² Business Week, 11 qershor 2001, "No growth pickup until yearend", fq 17.

dhe të eksporteve gjermane drejt Amerikës, e diktuar kjo nga rënia e ekonomisë amerikane. Megjithëse indeksi i publikuar është realizuar para se Banka Qendrore Europiane të ulte normat e interesit me 0.25 pikë përqindje, analistët besojnë se Gjermania do të kërkonte norma më të ulëta interesi për të rigjallëruar rritjen ekonomike³. Nga ana tjetër, shenjat për rritjen e presioneve inflacioniste në Gjermani dhe Itali, e bëjnë të vështirë një ulje tjetër të normave të interesit. Niveli i inflacionit në Gjermani gjatë muajit prill shënoi 3.3 për qind dhe në maj tendencat janë në rritje, ndërsa në Itali inflacioni shënoi 3.1 për qind. Raporti i publikuar nga Bundesbank thekson se rritja ekonomike, gjatë tremujorit të parë, ishte 0.5 për qind në bazë tremujore, ose 2 për qind në bazë vjetore.

Për më tepër, në tremujorin e dytë pritet që rritja ekonomike të shënojë rënie të mëtejshme. Po kështu, shenja të rënies kanë filluar të shfaqen edhe në ekonominë franceze, ku shpenzimet e konsumit gjatë muajit prill ranë 0.8 për qind. Përkundrajt një rritjeje prej 2.3 për qind të shënuar gjatë tremujorit të parë (në bazë vjetore), ekonomia italiane pritet të shënojë një rritje vjetore prej 2 për qind.

Qeveria e re pritet të marrë disa masa të karakterit fiskal me synim nxitjen e rritjes së kërkesës së brendshme (uljen e taksave, përjashtime për riinvestime të fitimeve, rritjen e programeve të punëve publike nëpërmjet emetimit të borxhit të qeverisë etj.).

Këto politika kanë krijuar shqetësime se qeveria nuk do t'i përmbahet niveleve të deficitit të parashikuara për zonën e euros. Nivelet e inflacionit qëndrojnë mbi nivelin e referencës në ekonominë italiane dhe greke: në fund të muajit prill, treguesi i inflacionit në nivel vjetor në të dy vendet qëndron mbi 3 për qind.

Shumë analistë besojnë se rritja e ekonomisë së zonës së euros do të jetë nën nivelet e parashikuara në fillim të vitit. Rritja ekonomike mesatare e zonës së euros për vitin 2001 pritet të jetë 2.3 për qind.

Zhvillimet në ekonominë e rajonit të Ballkanit duket se janë dominuar ndjeshëm nga situata politike në Maqedoni dhe kapërcimi i krizës së ekonomisë turke. Që nga fundi i vitit të kaluar, FMN miratoi një kredi *stand-by* prej 3.7 miliardë dollarësh për kapërcimin e krizës së ekonomisë turke, e ardhur nga dështimi i monedhës së vendit. Totali i kredive për Turqinë, të ofruara nga FMN, deri në maj të këtij viti, arrin në 19 miliardë dollarë.

Programi i daljes së ekonomisë nga gjendja aktuale përfshin thellimin e reformave në sistemin bankar; privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe liberalizimin në sektorët e energjisë, të telekomunikacionit etj.. Një program dhjetëmuor për mbështetjen e reformave ekonomike nga FMN dhe Banka Botërore, u nënshkrua edhe me ish-Republikën Federative të Jugosllavisë. Megjithatë, ekonominë ballkanike janë pak të integruara me njëra-tjetrën, e për rrjedhojë, ecuritë e ekonomive individuale ndikohen pak nga zhvillimet e rajonit në tërësi.

III. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E BRENDSHME.

III.1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME.

Në përgjithësi, karakteristikë që vërehet për ekonominë shqiptare në tremujorin e parë të çdo viti, e pranishme edhe në vitin 2001, është një lloj mpirjeje në dy muajt e parë dhe rigjallërim i aktivitetit ekonomik në muajin pasardhës e në vazhdim.

Aktiviteti industrial në sektorin shtetëror. Gjykimi mbi zhvillimet në sektorin e industrisë duhet theksuar se shprehet me rezervë për shkak të mbulimit të kufizuar të tij me të dhëna. Përgjithësisht informacioni disponohet për sektorin shtetëror, i cili, siç dihet, i është nënshtruar

³ Të dhënat janë marrë nga "The Economist", May 2001; Euro-Insider, May 28, 2001; Banque Centrale Europeenne, Bulletin Mensuel, Mai 2001.

procesit të privatizimit dhe/ose likuidimit. Kështu, prodhimi mall i shitur për sektorin e industrisë⁴ ka tendencë rënësë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues ra me rreth 19 për qind. Rënia më e ndjeshme u regjistrua në sektorin e minierave në masën 34.4 për qind.

Në këtë sektor industria e bakrit vazhdon të mosfunksionojë, ndërsa industria e qymyreve dhe e mineraleve të tjera shënoi vlerat më të ulëta të sektorit të minierave, rënie prej rreth 83.7 për qind krahasuar me një vit më parë.

Në këto zhvillime do të veçonim industrinë përpunuese, e cila regjistroi një rritje të prodhimit mall të shitur në krahasim me një vit më parë në masën 8.3 për qind.

Tkurrijen e aktivitetit industrial në sektorin shtetëror e konfirmon edhe niveli prej 51.9 i indeksit të prodhimit industrial për tremujorin e parë të vitit 2001, i cili ka rënë me rreth 2.4 pikë përqindjeje në krahasim me një tremujor më parë.

Tabela 1. Ecuria e prodhimit industrial.

Treguesit (në % kundrejt vitit 1993)	2000		2001			
	T4	T1	Janar	Shkurt		
Prodhimi industrial në volum	54.3	51.9	86.1	68.3	97.9	81.3
-Industria nxjerrëse	28.6	28.8	28.6	25.9	32.1	28.7
-Industria përpunuese	53.2	46.5	74.6	59.9	116.5	75.3
-Prodhimi i energjisë elektrike	106.3	117.8	100.6	100.6	122.3	117.9

Burimi: INSTAT.

Siç vërehet, në industrinë nxjerrëse dhe në atë të prodhimit të energjisë elektrike vërejmë rritje prej përkatësisht 0.2 dhe 11.5 pikë përqindjeje në krahasim me një tremujor më parë. Ndërsa, industria përpunuese ka pësuar rënie me rreth 6.7 pikë përqindjeje. Po kështu, muaji mars shënon nivelet më të larta të prodhimit industrial gjatë gjithë tremujorit të parë. Gjithësesi, nuk mund të konkludohet që kjo tendencë do të vazhdojë. Të dhënat për muajin prill 2001 flasin për nivele prodhimi të afërta me ato të tremujorit të parë, por që në krahasim me muajin mars kanë rënie të konsiderueshme sidomos në industrinë përpunuese.

Sektori privat. Përsa i takon sektorit privat mund të gjykohet nëpërmjet disa treguesve indirektë dhe mund të pohojmë se vazhdon tendenca e gjallërimit të tij.

Kështu importi i makinerive dhe pajisjeve arriti në 8.8 miliardë lekë, ose rreth 33.7 për qind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Muaji me nivel më të lartë në këtë lloj investimi evidentohet përsëri marsi, në të cilin janë realizuar rreth 38.3 për qind të totalit të tremujorit.

Konsumi i çimentos për tremujorin e parë të këtij viti ishte rreth 267 mijë ton, ose rreth 22.3 për qind më shumë se një vit më parë. Përsëri muaji me nivel më të lartë të konsumit të dukshëm të këtij produkti është marsi, në të cilin është konsumuar apo investuar rreth 40 për qind e totalit të tremujorit. Po kështu, karakteri i konsumit të këtij produkti ndikohet edhe nga efektet sezonale, pasi edhe vetë aktiviteti ndërtimor ka më shumë gjallëri në stinën e pranverës dhe të verës. Nisur nga tendencat paraardhëse, ky konsum pritet të rritet në tremujorin e dytë dhe të tretë të

⁴ Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Sektori i Statistikës, mars 2001.

vitit. Njëpërmjet këtij konkludojmë me përafërsi se sektori i ndërtimit ka vazhduar të ketë rritje të aktivitetit.

Nga ana tjetër, privatizimi i fabrikave të rëndësishme të çimentos krijon premisa që në të ardhmen e afërt, prodhimi i vendit të jetë parësor duke plotësuar pjesën më të madhe të nevojave të vendit për këtë produkt, në masën rreth 60 për qind.

Siç dihet, sektori i ndërtimit ka patur rritje të shpejtë në dekadën e kaluar duke kontribuar në rritjen e ekonomisë, jo vetëm njëpërmjet ndikimit të drejtpërdrejtë në raport me peshën që ka në PBB, por edhe njëpërmjet krijimit të mundësisë së zhvillimit të aktivitetit të një zinxhiri sektorësh si ai i importit apo prodhimit të lëndëve të para për ndërtim; i sektorit të shërbimit (mobilim, mirëmbajtje etj.), e deri në hapjen e vendeve të punës. Ritmi i lartë i rritjes së këtij sektori të ekonomisë është mundësuar nga kërkesa e lartë si për banesa apo ambiente për të zhvilluar biznes, ashtu edhe nga fondet e disponueshme për këtë qëllim. Për më tepër, duke qenë një aktivitet fitimprurës, financimi i tij ka zënë rreth 1/4 e portofoleve të huave të bankave.

Deri më sot, ky aktivitet është zhvilluar dhe në një mjedis shumë liberal, ku shpesh nuk është respektuar as kërkesa më minimale, marrja e një lejeje ndërtimi. Nga ana tjetër, po shtohen përpjekjet për forcimin e shtetit ligjor dhe zbatimin rigoroz të ligjeve në çdo aspekt, përfshi dhe fushën e ndërtimit. Përveç kësaj, gjatë 10 viteve të kaluara është plotësuar ndjeshëm kërkesa për ndërtime. Veprimi i faktorëve të tillë do të bëjë që të mos mund të ruhet ritmi i lartë i rritjes për këtë sektor. Kjo do të sjellë për pasojë uljen e efikasitetit të atij zinxhiri aktivitetesh, që janë të lidhura me sektorin e ndërtimit. Përveç kësaj, aktiviteti i ndërtimit është ndër aktivitetet e financuara më së shumti drejtpërdrejt me parapagim nga klientët. Ndoshta, kufizimi i tij mund të shoqërohet dhe me probleme në aftësinë paguese, aq më tepër që edhe financimi nga sektori bankar është realizuar në nivel më të ulët se sa pritshmëria për periudhën janar - maj 2001⁵. Kreditë e akorduara për këtë sektor në tremujorin e parë të vitit 2001 përfaqësojnë 24.7 për qind të portofolit gjithsej të huave të bankave duke u reduktuar me 0.3 pikë përqindjeje kundrejt tremujorit paraardhës.

Banka e Shqipërisë beson që përmirësimi i klimës së investimeve, të vendit dhe të huaja, rritja e investimeve publike si dhe zhvendosja drejt aktivitetit prodhues krijojnë premisa për të kompensuar çdo tkurrje aktiviteti në sektorët e tjerë të ekonomisë dhe për të mbështetur rritjen ekonomike.

Të dhënat mbi investimet në infrastrukturë në sektorë të tjerë të rëndësishëm të ekonomisë, si në atë të transportit rrugor, tregojnë se ky tremujor ka shënuar nivele të kënaqshme, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ato janë realizuar në masën 91.67 për qind, apo rreth 17.5 për qind të programit vjetor për to⁶. Gjithashtu, edhe ky informacion nuk paraqet volumin e përgjithshëm të punimeve në këtë sektor, pasi një pjesë e investimeve në infrastrukturë kryhen drejtpërsëdrejti nga pushteti lokal. Megjithatë, vlerësohet që investimet në këtë fushë të jenë të konsiderueshme, sidomos në gjysmën e parë të vitit 2001.

Kërkesa e brendshme. Disa nga treguesit e kërkesës së brendshme flasin për rritje të saj. Konkretisht, konsumi i energjisë elektrike është rreth 2.8 herë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë; konsumi i karburanteve si edhe importi i autoveturave kanë shënuar rritje, ndonëse të lehta, në periudhat krahasuese.

Megjithatë, importet e pajisjeve elektro-shtëpiake kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Konkretisht, janë importuar rreth 2.3 herë më pak produkte të tilla. Ky fenomen është e qartë që reflekton si reduktimin e fuqisë blerëse, ashtu edhe ngopjen e tregut me këto lloje produktesh dhe për pasojë reduktimin e kërkesës së

⁵ Sipas opinionit të specialistëve të kreditit në banka për ecurinë dhe pritshmërinë e kreditimit për periudhën janar - maj 2001.

⁶ Burimi: Ministria e Transporteve.

natyrshme për to. Ndoshta, peshë më të madhe në këtë reduktim mund t'i jepet faktorit që ka të bëjë me ngopjen e tregut. Kjo për faktin se, nëse do t'i referoheshim të dhënave të indeksit të çmimeve të grupmallrave përkatëse, ai ka pësuar ulje të vazhdueshme për mëse dy vjet rradhazi. Më konkretisht, çmimet e këtij grupmali janë reduktuar me 1.7 për qind kundrejt një viti më parë. Ndërsa në pesë muajt e parë të vitit kundrejt fundit të vitit 2000, ky tregues është po me reduktim në masën 0.8 për qind.

Nëse krahasohet kjo shifër me fundin e vitit 2000 përsëri vërehet një reduktim i konsiderueshëm, prej afro 61 për qind, i cili më së shumti shpjegohet me natyrën sezonale të kërkesës. Gjithmonë fundi i vitit karakterizohet nga një kërkesë më e madhe për këto lloje produktesh.

Inflacioni. Norma vjetore e inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2001 arriti në nivelin 3 për qind. Duke u bazuar dhe në ecurinë në muajt vijues (2.5 për qind në muajin maj) vërehet një tendencë rënëse dhe në përputhje me parashikimet.

Tregu i punës. Situata në tregun e punës për këtë tremujor paraqitet e përmirësuar. Shkalla e papunësisë ra në 15.96 për qind ndërsa numri i të punësuarve u rrit në 1.1 milionë vetë.

III.2. SITUATA NË TREGUN E PUNËS.

Tremujori i parë i vitit 2001 tregoi se tregu i punës u karakterizua nga tregues të përmirësuar të tij, krahasuar me periudhat e mëparshme. Ky tremujor u mbyll me një shkallë papunësie rreth 15.96 për qind, ose me një rënie të lehtë prej 0.9 pikë përqindjeje kundrejt fundit të vitit të kaluar. Tendenca rënëse e numrit të të papunëve është vërejtur gjatë gjithë tremujorit dhe siç pritej, gjallërimi i aktivitetit ekonomik në muajin mars ka bërë që edhe numri i të papunëve të ulet më tej në këtë muaj duke arritur në rreth 200 mijë kundrejt 205 mijë të tremujorit. Për më tepër, kjo tendencë vazhdon edhe në muajin prill. Vlerësohet që intensifikimi i investimeve në infrastrukturë në tremujorin e dytë të vitit do të ndikojë në reduktimin e mëtejshëm të papunësisë.

Tabela 2. Papunësia në tremujorin e parë 2001.

Treguesit (në mijë)	2000		2001			
	T 4	T 1	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Të papunë gjithsej	217	205	210	204	200	197.4
Përfitojnë pagesë papunësie	21	21	20	21	21	20.7
Shkalla e papunësisë (në %)	16.9	15.96				

Burimi: INSTAT.

Krahas rënies së nivelit të të papunëve, evidentohet edhe një përmirësim i ndjeshëm në treguesit e punësimit. Numri i të punësuarve në këtë tremujor arriti në 1.1 milionë vetë ose 14 mijë më shumë se një tremujor më parë. Rritja e të punësuarve është kryesisht pasojë e rritjes së punësimit në sektorin privat jobujqësor. Edhe ky tregues mbështet në mënyrë të tërthortë vlerësimin për gjallërimin e aktivitetit në sektorin privat.

Tabela 3. Punësimi në tremujorin e parë 2001.

Treguesit (në mijë)	Trem. IV 2000	Trem. I 2001
Forca e punës	1281	1283
-Të punësuar gjithsej	1064	1078
Nga këta:		
- në sektorin shtetëror	194	198
- në sektorin privat jobujqësor	109	119
- në sektorin privat bujqësor	761	761

Burimi: INSTAT.

Megjithatë, vlerësimi i tregut të punës përmban rezerva për shkak të dy problemeve madhore, të cilat deformojnë situatën e paraqitur nga shifrat e mësipërme:


- tregu i zi i punës është ende i pavlerësuar;
- ruajtja e një niveli konstant punësimi në sektorin privat bujqësor prej disa vitesh.

III.3. ZHVILLIMET FISKALE.

Në përgjithësi, situata e buxhetit të shtetit në tremujorin e parë të vitit 2001 paraqitet e përmirësuar si pasojë e realizimit të të ardhurave, e rritjes së nivelit të realizimit të shpenzimeve, sidomos atyre kapitale, e respektimit të kufijve për deficitin buxhetor dhe për financimin e tij. Megjithatë, investimet në infrastrukturë dhe sidomos intensifikimi i tyre në tremujorin e dytë të vitit kërkojnë ndjekje të kujdesshme në vijimësi të këtyre treguesve, sidomos për të qenë të përgatitur për të reaguar kundrejt kryerjes së shpenzimeve "surprizë". Të tilla probleme zakonisht kanë shoqëruar periudhat e zgjedhjeve të përgjithshme.

III.3.1. Të ardhurat buxhetore.

Niveli i të ardhurave të realizuara në fund të tremujorit të parë të vitit 2001 është rreth 29.9 miliardë lekë, ose rreth 318 milionë lekë më shumë se sa parashikimi për këtë tremujor. Ndërsa në raport me parashikimin vjetor, ato janë realizuar në masën 21.9 për qind. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat përbëjnë grupin më me peshë në të ardhurat buxhetore, gjithashtu, janë realizuar në masë të konsiderueshme. Për këtë tremujor ato zunë rreth 97.3 për qind të të ardhurave gjithsej.



Duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet gjatë muajit prill 2001 mund të konkludojmë se, në përgjithësi, është ruajtur një ritëm i rregullt i vjeljes së të ardhurave buxhetore, me përjashtim të muajit shkurt, i cili shënoi një mosrealizim të të ardhurave me rreth 2.8 për qind kundrejt parashikimit.

Ndërsa, muaji prill u karakterizua nga niveli më i lartë i realizimit të tyre në masë absolute si edhe duke u krahasuar me parashikimin e katërmujorit. Në terma relative, të ardhurat në total

janë tejkualuar në masën 6.4 për qind, krahasuar me parashikimin e tyre deri në fund të prillit 2001.

III.3.2. SHPENZIMET BUXHETORE.

Zëri i shpenzimeve buxhetore merr një rëndësi të veçantë studimi në situatat në të cilat po kalon vendi. Ruajtja e stabilitetit makroekonomik të vendit lidhet, në mënyrë të ngushtë, me kryerjen e shpenzimeve në mënyrë të kontrolluar dhe brenda kufijve të programuar si edhe me ndjekjen e kryerjes së zërave të veçantë të tyre. Kjo analizë fokusohet, kryesisht në efektet negative që ushtron mosndjekja dhe kryerja e shpenzimeve buxhetore pa kriter, mbi treguesin e inflacionit të pritshëm. Periudha e parë e këtij viti, dëshmoi për përpjekjet e kujdesshme të qeverisë për të mos tejkualuar shpenzimet përtej parashikimeve.

Fundi i marsit 2001 shënoi një nivel shpenzimesh prej rreth 35.9 miliardë lekësh, dhe me një realizim prej afro 7 për qind më pak se sa parashikimi i tyre për këtë periudhë. Në krahasim me parashikimin vjetor ato janë realizuar në masën 18.8 për qind.


Në strukturën e shpenzimeve, vendin më të konsiderueshëm e zunë shpenzimet korente, rreth 87 për qind të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që shpenzimet kapitale zunë rreth 12.5 për qind të tyre.

Duke marrë në konsideratë zhvillimet në muajin prill vërehet se, përgjatë gjithë periudhës katërmujore, nuk konstatohen tejkualime në kryerjen e shpenzimeve buxhetore. Nga ana tjetër, vërehet një shpërndarje pothuajse e rregullt e tyre gjatë të katër muajve të parë të këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe, megjithëse shpenzimet u mbajtën nën kontroll për të mos kaluar nivelet e parashikuara, në zërin shpenzime kapitale, evidentohet një tendencë rritëse e shpejtë si në parashikimin e tyre, ashtu edhe në kryerjen faktike të tyre nga njëri muaj në tjetrin. Ky fakt lidhet me iniciativën e qeverisë për të kryer një varg shpenzimesh me natyrë investuese në periudhën mars-prill dhe që vazhdoi edhe në maj e qershor të këtij viti. Është e qartë që shpenzime të tilla vlejné të përshëndeten për ndikimet pozitive që ato japin në rritjen e ardhshme ekonomike të vendit, në zhvillimin e infrastrukturës së tij si edhe për ndikimet pozitive në treguesit e papunësisë duke rritur shkallën e punësimit në vend. Sidoqoftë, ato duhet të kryhen në mënyrë të studiuar për të mos cënuar tregues të rëndësishëm makroekonomikë, si edhe për të mos patur në të ardhmen e afërt presione inflacioniste në ekonomi.

Tabela 4: Realizimi i shpenzimeve kapitale kundrejt parashikimit (në %).

Shkurt	Mars	Prill
63.9	75.9	85.7



III.3.3. DEFICITI BUXHETOR.

Deficiti buxhetor në fund të muajit mars 2001 arriti në rreth 6 miliardë lekë ose 66.4 për qind e parashikimit për tremujorin e parë. Ndërsa duke iu referuar parashikimit të tij për vitin 2001, ai u realizua në masën 11 për qind. Deri në fund të kësaj periudhe, rreth 49.3 për qind u financua nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër e tij nga burime të huaja. Karakteristikë për këtë vit është parashikimi i financimit të konsiderueshëm të deficitit me të ardhurat nga privatizimit. Kjo karakteristikë u bë e dukshme që në tremujorin e parë të vitit. Të ardhurat nga privatizimi arritën shifrën 3 miliardë lekë. Ato u realizuan në masën 50.5 për qind në krahasim me parashikimin e tremujorit të parë të vitit 2001 dhe siguruan financimin e 51.3 për qind të deficitit.

Tabela 5. Treguesit fiskalë të buxhetit të shtetit (të dhëna progresive në milionë lekë).

Komponentët e buxhetit	Janar 2001	Shkurt 2001	Mars 2001	Plani mars 2001	Prill 2001	Plani prill 2001	Parashikimi për vitin 2001
Të ardhurat totale:	7710	17987	29878	29560	42949	40372	136462
-të ardhurat nga fondi kundërparti	0	0	0	0	0	0	0
-të ardhurat tatimore	5880	13635	21381	20310	28618	27640	94900
-kontributet e sigurimeve shoqërore	1410	3461	5455	4740	6811	6390	22585
-të ardhurat jotatimore	420	891	3042	4510	7520	6342	18977
Shpenzimet totale:	11683	22068	35845	38543	49001	52173	190496
-shpenzimet korrente	9473	19567	31182	31333	41575	41963	137633
-shpenzimet kapitale	1600	2309	4471	5800	7227	8400	43903
-Kosto e ristrukt. të bankës	210	192	192	210	199	210	3010

-Fondi rezervë	400			1200		1600	5950
Deficiti buxhetor:	3973	4081	5967	8983	6052	11801	54035
-financim i brendshëm	-157	631	2943	2396	-669	3734	27313
-financimi i huaj	4130	3449	5325	6587	6720	8240	26895

Burimi: Zyra e përfaqësuesit rezident të FMN-së, Tiranë.

III.4. ZHVILLIMET NË INFLACION.

Objektivi i përcaktuar për inflacionin në vitin 2001 mbeti në të njëjtat nivele si edhe në vitin 2000. Megjithatë, niveli i inflacionit mujor në muajin dhjetor 2000 dhe tejkalimi i objektivit për 0.2 pikë përqindjeje në fund të këtij viti krijoi shqetësim për ecurinë e inflacionit në vitin 2001. Edhe pse dihej që muaji dhjetor ka një efekt të ndjeshëm të sezonit, përsëri nuk ishte e qartë se deri në çfarë mase ishte shtrirja e këtij efekti. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, periudha pararendëse ishte karakterizuar nga kriza energjitike e kombinuar me një konjunkturë ndërkombëtare të pafavorshme të çmimeve të naftës. Për më tepër, problemet me energjinë elektrike vijuan edhe në muajt e parë të vitit 2001 dhe në gjashtëmujorin e parë të tij u mbajtën gjedhjet e përgjithshme.

Këto shqetësime u sheshuan me ecurinë e inflacionit gjatë kësaj periudhe. Zhvillimet e faktuara në tremujorin e parë të vitit 2001 e më tej, flasin për një normë inflacioni në rënie dhe vazhdimisht brenda kufijve të përcaktuar si objektivi. Kështu, në dy muajt e parë të vitit normat mujore të inflacionit ishin negative për 1.3 për qind përkatësisht për secilin muaj. Ekzistojnë shkaqe të besueshme që mbështesin këtë ecuri të çmimeve të konsumit. Historikisht, në muajin janar çmimet fillojnë e bien pas ngritjes spekulative që ato pësojnë në fundit të vitit. Gjatë vitit 2001, rënia e çmimeve ishte e pranishme dhe në muajin vijues. Reduktimi i normës së inflacionit gjatë muajve janar dhe shkurt është pothuaj i barabartë me rritjen e çmimeve të muajit dhjetor që do të thotë se spekulimi i muajit dhjetor është "shuar" për dy muaj. Shkalla relativisht e ulët e aktivitetit ekonomik, i cili gjallërohet në muajin e fundit të tremujorit të parë, shoqërohet dhe me një kërkesë të reduktuar konsumatore duke ndikuar në norma të ulëta inflacioni. Nga ana tjetër, muajt e parë të vitit 2001, megjithë vazhdimin e thatësisë, u karakterizuan nga një situatë më e lehtësuar energjitike ndërkohë që çmimet e karburanteve kishin filluar të binin përsëri në nivelet e parakrizës.


Zhvillimet e muajit mars, muaj gjatë të cilit inflacioni vjetor u rrit në 2,9 për qind pasqyrojnë ndikimin e plotë të vonuar të shpenzimeve buxhetore të përqëndruara në muajin dhjetor të çdo viti. Ndërkohë, në fund të muajit maj inflacioni u reduktua më tej në 2.54 për qind. Bazuar në këtë ecuri, **Banka e Shqipërisë gjykon se aktualisht objektivi për inflacionin është i arritshëm.**

Tabela 6. Ecuria mujore e çmimeve të konsumit (në %).

	1998	1999	2000	2001
Janar	3.5	0.9	0.3	-1.3
Shkurt	1.8	-0.6	-0.3	-1.3


Mars	1.2	-0.3	-1.1	0.3
Prill	1.6	0.0	0.7	0.85
Maj	-0.2	-0.6	0.7	0.20
Qershor	-1.7	-2.3	-2.1	
Korrik	-2.0	-1.3	-2.7	
Gusht	0.4	-0.3	0.4	
Shtator	1.4	0.1	1.7	
Tetor	0.3	0.4	1.3	
Nëntor	0.2	0.8	0.8	
Dhjetor	2.1	2.2	4.6	

Burimi: INSTAT.



III.5. Zhvillimet në kursin e këmbimit.

Pas mbiçmimit të dollarit amerikan gjatë muajit mars, tregjet valutore nuk kanë regjistruar luhatje të rëndësishme në muajt pasardhës (prill-maj). Pas një mbiçmimi të përkohshëm të euros të regjistruar në gjysmën e dytë të muajt prill, e lidhur kryesisht me vendimin e Fed-it për uljen me 50 pikë të normës bazë të interesit, monedha europiane ka ruajtur tendencën e nënçmimit të saj ndaj dollarit që nga fillimi i vitit. Raporti mesatar i kursit nominal të këmbimit euro/dollarë ishte 0.938. Në fund të muajt prill, ky raport ra në 0.892, ose i nënçmuar me 5.8 për qind kundrejt një viti më parë.




Burimi: Banque Centrale Europeenne, Bulletin Mensuel, Mai 2001.

Zhvillimet në tregun e brendshëm valutor kanë ndjekur dhe kanë pasqyruar zhvillimet në raportet mes monedhës amerikane dhe asaj europiane. Pas një niveli mesatar të këmbimit prej 146.08 dollarë amerikanë gjatë muajit dhjetor 2000, leku u mbiçmua në fillim të këtij viti.

Niveli i kursit të këmbimit në raport me dollarin amerikan në muajin janar, shënoi 141.74, duke vazhduar të regjistrojë një prirje të lehtë graduale drejt nënçmimit. Ndërkohë, sjellja e kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhës së re europiane, euro, ishte krejt më e ndryshme

se ndaj dollarit. Gjatë muajit dhjetor leku u shkëmbye me një kurs mesatar prej 130.79 kundrejt euros, duke e ndryshuar tendencën në muajin janar, ku kursi këmbimit arriti në 133.01. Pas këtij zhvlerësimi, leku filloi të forcohet ndaj euros, duke shënuar nivelin 129.94 lek/euro në fund të muajit prill. Që nga fillimi i vitit, leku është nënçmuar vazhdimisht ndaj monedhës amerikane dhe është mbiçmuar ndaj euros. Në fund të muajit maj, leku është nënçmuar me 2.6 për qind ndaj dollarit dhe është mbiçmuar me 2.3 për qind ndaj euros.



III.6. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë.

Tremujori i parë i vitit 2001 shënoi një rritje të aktivitetit ekonomik midis Shqipërisë dhe pjesës tjetër të botës. Të ardhurat e llogarisë korente vlerësohen në 361.3 milionë dollarë, ose 16.8 për qind më të larta se viti i kaluar, ndërsa daljet (gjendja debitore) shënuan 408.4 milionë dollarë, duke u rritur me 25.5 për qind përkundrejt të njëjtës periudhë. Për rrjedhojë, deficitin e llogarisë korente u rrit nga 16.1 milionë, në 47.1 milionë dollarë. Importet e larta të kapitaleve kanë mbuluar tërësisht deficitin korent dhe kanë çuar në rritjen e rezervave valutore me 48.2 milionë dollarë.

Peshën kryesore që përcakton sjelljen e bilancit të llogarisë korente e mban aktiviteti tregtar i mallrave. Deficitin e bilancit tregtar gjatë kësaj periudhe arriti në 206.9 milionë dollarë, duke shënuar një rritje të ndjeshme prej rreth 25 për qind përkundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar. Megjithatë eksportet u rritën me 23 për qind (duke kapur shifrën 78.5 milionë dollarë), importet e tejkaluan këtë ritëm rritjeje, duke shënuar shifrën prej 25.6 për qind, ose 58.1 milionë dollarë më shumë se tremujori i parë i vitit 2000.

Duke analizuar të dhënat e bilancit tregtar, spikat një rritje e ndjeshme e importeve të makinerive e pajisjeve me rreth 72 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 43.4 milionë dollarë nga 25.3 milionë. Nga ana tjetër, rritja në shifrat e importeve është ndikuar nga një rritje e zërave të lëndëve të para të industrisë përpunuese për eksport. Importet e lëndëve të para të industrisë tekstile dhe lëkurës janë rritur me 33 dhe 16 për qind, respektivisht, ndërsa eksportet në këta dy zëra janë rritur me 39 dhe 30 për qind, respektivisht.

Pas deficiteve të tre tremujorëve të fundit të vitit 2000, bilanci i shërbimeve këtë tremujor u kthye përsëri në shifra pozitive me rreth 16 milionë dollarë. Eksporti i shërbimeve vlerësohet në rreth 123 milionë dollarë dhe kjo është mundur kryesisht prej shërbimeve të turizmit, të cilat zënë rreth 80 për qind të kësaj shume. Pjesën tjetër e përfaqësojnë shërbimet e telekomunikacionit dhe ato qeveritare. Importi i shërbimeve vlerësohet rreth 107 milionë dollarë. Në shpenzimet për importin e shërbimeve, peshën kryesore e zënë shërbimet e turizmit dhe ato të transportit, respektivisht me 60 dhe 22.4 për qind. Këto të fundit janë rritur rreth 18 për qind kryesisht si pasojë e rritjes së importit.

Edhe bilanci i të ardhurave vlerësohet pozitiv me rreth 26 milionë dollarë ose 54

për qind më i lartë se tremujori i parë i një viti më parë. Kjo rritje është kryesisht rrjedhojë e të ardhurave më të larta nga investimet e rezervave dhe të ardhurave nga puna e punonjësve sezonalë. Investimet e rezervave jashtë vendit vlerësohen në 14.8 milionë dollarë, ose 27.5 për qind më të larta se tremujori i parë i vitit të kaluar. Kjo ishte rrjedhojë e rritjes së shumave të investuara jashtë vendit, gjë që ka kompensuar efektet negative të rënies së normave të interesave në tregjet ndërkombëtare që kanë ndodhur gjatë këtij viti.

Transfertat korente vlerësohen me një bilanc pozitiv prej rreth 118 milionë dollarë. Rolin kryesor në këtë suficit e luajnë dërgesat nga emigrantët, që për këtë tremujor, vlerësohen rreth 124.5 milionë dollarë amerikanë ose rreth 45 për qind më shumë se në tremujorin e parë të vitit të kaluar.


Deficiti relativisht i lartë i transaksioneve korente është financuar prej flukseve hyrëse të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 56 milionë dollarë dhe përfaqëson 80 për qind të tremujorit të parë të vitit të kaluar. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale prej rreth 28 milionë dollarësh dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 48 milionë dollarësh. Detyrimet financiare kundrejt jorezidentëve kapën shifrën prej 84 milionë dollarësh, ku rolin kryesor e kanë luajtur investimet e huaja direkte dhe disbursimet e kredive të huaja. Kështu, investimet e huaja regjistruan shifrën 58 milionë dollarë, kryesisht nga arkëtimet nga procesi i privatizimit.

IV. ZHVILLIMET MONETARE.

Në programin monetar të vitit 2001 Banka e Shqipërisë ka skicuar linjat kryesore të zhvillimeve të pritshme monetare. Duke u bazuar në parashikimet për një rritje reale të ekonomisë në nivelin 7.3 për qind dhe në objektivin e saj për një rritje vjetore të çmimeve të konsumit në masën 2 - 4 për qind, Banka e Shqipërisë ka përcaktuar si objektivi të ndërmjetëm të saj rritjen e ofertës monetare në masën 11.2 për qind. Kjo rritje e ofertës monetare do të mbulojë kërkesën e ekonomisë për mjete monetare dhe të qeverisë për financimin e brendshëm të deficitit të saj. Gjatë vitit 2001, stoku i kredisë për ekonominë parashikohet të rritet me 8.1 miliardë lekë, ndërsa financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar parashikohet të jetë 18.5 miliardë lekë. Gjithashtu, sistemi bankar shqiptar do të përmirësojë pozicionin e jashtëm valutor, gjë që reflektohet në rritjen e mjeteve valutore të tij.

Zhvillimet monetare, gjatë tremujorit të parë, janë karakterizuar nga një rritje e ndjeshme e ofertës monetare, ndonëse në ritme disi më të ulëta se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Rritja vjetore e ofertës së parasë, në fund të muajit mars 2001, ishte në nivelin 14.4 për qind, vetëm 0.5 pikë përqindjeje nën vlerën e parashikuar nga Banka e Shqipërisë në programin monetar të saj.

⁷ Sipas miratimit në Kuvend.




Rritja e ofertës monetare, në ndryshim nga viti i kaluar, është tërësisht rrjedhojë e rritjes së depozitave në sistem, ndërkohë që paraja jashtë bankave, aktualisht, shënon një rënie nga nivelet e larta të arritura në fund të vitit. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3, agregatit që përfaqëson ofertën monetare, zbriti në 28 për qind në fund të tremujorit duke qenë afër niveleve të regjistruara në të njëjtën periudhë të vitit të shkuar. Ndërkohë, rënia e saj në vlerë absolute ishte 4.45 miliardë lekë. Një rënie prej 3 miliardë lekësh pësuan edhe depozitat pa afat në lekë, duke sjellë kështu një ulje të agregatit M1 prej 7.45 miliardë lekësh. Raporti i tij ndaj totalit të ofertës monetare, agregatit M3, kaloi nga 37.8 për qind në dhjetor '00 në 34.5 për qind në mars '01.

Banka e Shqipërisë e priste një zhvillim të tillë, ndonëse jo në këto përmasa. Niveli i lartë i agregatit M1 i regjistruar në dhjetor 2000, ishte jashtë tendencës historike të tij. Normalisht, një nivel i lartë i agregatit M1, përbërësi më likuid i ofertës monetare, ofron një tregues të mirë të presioneve inflacioniste në ekonomi. Në kontrast me këtë tendencë rënëse të M1, në tremujorin e parë të vitit, depozitat me afat në lekë patën një rritje të ndjeshme prej 8.36 miliardë lekë, duke sjellë një rritje totale të depozitave në lekë prej 5.36 miliardë lekë. Zhvillimet monetare në Shqipëri kanë treguar se, ndonëse ritmet e rritjes së depozitave me dhe pa afat në lekë ndryshojnë në periudha të ndryshme, kahu rritës apo zbritës i lëvizjes së tyre përgjithësisht ka qenë i njëjtë. Kështu, në tremujorin e fundit të vitit 2000, depozitat pa afat në lekë u rritën me 3.8 miliardë lekë ndërsa ato me afat u rritën me 4.7 miliardë lekë duke sjellë një rritje totale prej 8.5 miliardë lekë. Ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të shkuar, ulja e depozitave me afat në lekë me 1.9 miliardë lekë dhe ulja e depozitave pa afat në lekë me 1.2 miliardë solli një ulje të nivelit total të depozitave në lekë me 3.1 miliardë lekë. Rritja e depozitave me afat në lekë, në një masë të madhe, mund të shikohet edhe si një zhvendosje e brendshme e depozitave në lekë, nga depozita pa afat në depozita me afat. Ndonëse lëvizjet në të tilla përmasa janë të dëmshme, ato mund të shikohen edhe si levizje rregulluese të portofolit të agjentëve ekonomikë. Duke eliminuar ndikimin e efekteve spekulative të momentit, përputhja me e saktë e raportit të depozitave me dhe pa afat në lekë me nevojat reale të agjentëve ekonomikë, do të shërbejë në rritjen e interesit të sistemit bankar për financimin e investimeve afatgjata duke krijuar një nivel të duhur të pjerrësisë pozitive të kurbës së normave të interesit sipas afatit të maturimit.

Tabela 7. Përbërësit e ofertës monetare (në milionë lekë).

	Mars - 00	Qershor - 00	Shtator - 00	Dhjetor - 00	Mars - 01
Paraja jashtë bankave	83,423	85,568	91,950	99,236	94,782
Depozitat në Lekë	155,249	157,199	156,732	165,261	170,621
- me afat	134,793	135,464	135,734	140,456	148,816
- pa afat	20,456	21,735	20,998	24,805	21,805
M1	103,879	107,303	112,948	124,041	116,587
M2	238,672	242,767	248,682	264,497	265,403
Depozitat në valutë	56,735	57,077	63,045	63,604	72,536
M3	295,406	299,844	311,727	328,101	337,940

Edhe depozitat në valutë kanë patur rritje, por në ndryshim nga depozitat në lekë, kjo rritje është vërejtur në të gjithë spektrin e maturimit, si për depozitat me afat ashtu dhe për ato pa afat. Rritja totale e këtyre depozitave është 9 miliardë lekë, e ndarë në një rritje prej 4 miliardë lekë të depozitave me afat dhe 5 miliardë lekë të depozitave pa afat. Kjo ka sjelle një rritje me 2.1 pikë përqindjeje të peshës së tyre specifike ndaj M3. Kjo ka sjellë, në të njëjtën kohë dhe uljen e peshës së agregatit M2 ndaj ofertës monetare. Një zhvillim i tillë vështirëson procesin e hartimit dhe ul efektivitetin e zbatimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.



Ndërkohë që rritja e ofertës monetare ka qenë në ritme të larta, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për kërkesën e ekonomisë për të. Ndryshimi i kësaj kërkesë është i papërfillshëm gjatë tremujorit të parë. Kjo ka sjellë një zbalancim midis kërkesës dhe ofertës monetare duke ushtruar presion në uljen e normave të interesit të aktiveve monetare të emetuara në lekë, ndërkohë që normat e interesit të valutës ndjekin nga afër lëvizjet në tregjet ndërkombëtare të normave të interesit. Rënia e normave të interesit së bashku me gjallërimin e sektorit privat, ka çuar në një mbështetje më të madhe të ekonomisë me kredi. Gjithësesi, këtu ka vend për disa sqarime.

Kredia e re e dhënë në tremujorin e parë të vitit është 4.7 miliardë lekë, kundrejt 3.5 miliardëve të tremujorit të parë të vitit 2000. Por, duke qenë se kredia e re e akorduar në ekonominë shqiptare ka, përgjithësisht, një natyrë afatshkurtër, rritja e stokut të kredive në tremujorin e parë të vitit 2001, 0.63 miliardë lekë, është më e ulët se rritja koresponduese e stokut një vit më parë, 1.49 miliardë lekë. Edhe gjatë këtij viti, kredia në valutë ka qenë forma më e preferuar e kredihënies/marrjes. Stoku i kredive në valutë u rrit me 0.44 miliardë lekë ndërsa rritja e këtij

stoku për kreditë në lekë ishte vetëm 0.19 miliardë. Sipas sektorëve të ekonomisë, rritja e stokut është pasojë e rritjes së stokut të kredive në sektorin privat ndërkohë që ky stok paraqitet me ulje për sektorin shtetëror të ekonomisë.

Edhe kërkesa e qeverisë për financimin e deficitit të saj, elementi tjetër i kërkesës së brendshme për mjete monetare, ka qenë e ulët gjatë tremujorit të parë. Stoku i pretendimeve neto ndaj qeverisë është rritur vetëm me 0.6 miliardë lekë, e tëra kjo e financuar nga Banka e Shqipërisë.

Kjo situatë ka sjellë rritjen e likuiditetit të tepërt të bankave duke rritur presionet mbi rezultatet e tyre financiare. Në kushtet e konkurrencës së kufizuar në sistemin tonë bankar, kjo çon në rritjen e kostos së ndërmjetësimit të tij, si në formën e uljes së normave të interesit për depozitat ashtu edhe në ruajtjen e niveleve të larta të normës së interesit të kërkuar për investime në bono thesari apo në kredi duke krijuar kështu një burim për presione inflacioniste.

E ndodhur në këto kushte, Banka e Shqipërisë, me anë të instrumenteve të saj, e ka tërhequr këtë likuiditet të tepërt duke synuar kështu, nga njëra anë, uljen e presioneve inflacioniste nëpërmjet kontrollit të kostos së ndërmjetësimit të sistemit dhe, nga ana tjetër, ruajtjen e aftësisë thithëse të depozitave nga sistemi bankar.

Tërheqja e likuiditetit është kryer nëpërmjet instrumentit të marrëveshjeve të riblerjes, në formën e ankandeve të repove, portofoli i të cilave në Bankën e Shqipërisë u rrit me 7.8 miliardë lekë gjatë tremujorit të parë të vitit 2001, duke arritur në 13 miliardë lekë në mars '01. Kërkesa e ulët e qeverisë për financim dhe tërheqja e likuiditetit nga sistemi kanë kufizuar ekspansionin e bazës monetare. Gjatë tremujorit të parë të vitit ajo është ulur me afër 3.5 miliardë lekë.

Tremujori i parë ka shënuar edhe një përmirësim të pozicionit valutor të ekonomisë. Mjetet valutore neto të sistemit bankar janë rritur me 15.9 miliardë lekë, duke përbërë kështu edhe "përdorimin" kryesor të fondeve të krijuara në ekonomi. Rritja e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë është 8 miliardë lekë, ndërsa pjesa tjetër e rritjes, 7.9 miliardë lekë, përfaqëson rritjen e mjeteve valutore neto të bankave tregtare. Rritja e mjeteve valutore neto të ekonomisë, ndërsa në njërin anë përbën një përmirësim të pozicionit valutor të një vendi, nga ana tjetër tregon një mospërdorim shumë efektiv të fondeve valutore në dispozicion të ekonomisë shqiptare.

Zhvillimet monetare në tremujorin e parë të vitit 2001 janë përgjithësisht pozitive. Sistemi bankar ka ruajtur aftësinë thithëse të depozitave të qytetarëve, ndonëse këto kanë një preferencë në rritje të mbahen në valutë. Megjithëse kredia e re e akorduar në ekonomi ka qenë e lartë, si pasojë e natyrës afatshkurtër të saj ajo nuk arrin të përballojë rritjen e ofertës monetare. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë është e detyruar që me anë të instrumenteve të saj të ndërhyjë duke tërhequr likuiditetin e tepërt, për të balancuar kërkesën dhe ofertën e mjeteve monetare në ekonomi. Duke i vlerësuar në kompleks këto zhvillime monetare, Banka e Shqipërisë i shikon ato në përputhje me objektivin e saj për një rritje vjetore të ofertës monetare në masën 11.2 për qind në vitin 2001 duke mbajtur inflacionin vjetor në kufijtë 2 - 4 për qind.

V. ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT NË EKONOMI.

Edhe në tremujorin e parë të vitit 2001 Banka e Shqipërisë vazhdoi të zbatojë politikë monetare me kah zbutës, duke ndikuar në reduktimin e përgjithshëm të normave të interesit në ekonomi. Ky ndikim është transmetuar nëpërmjet normës së shpallur në ankandet e repove si dhe të shumës së rezervave të tepërta që thithen dhe lihen në sistem. Përveç kësaj, për të siguruar reagimin sa më të shpejtë dhe në drejtimin e duhur të bankave, u prezantuan dhe një sërë elementesh të reja ose filluan të kenë ndikim më të plotë elemente të tjera të prezantuara në fund të vitit 2000, siç është remunerimi i rezervës së detyrueshme pranë bankës qendrore apo

vendosja e rezervave të tepërta në depozita me afat njëditor po pranë bankës qendrore. Në tërësi, tendenca në tremujorin e parë të vitit ka qenë reduktimi i vazhdueshëm i normave të interesit, tendencë e vijuar edhe në muajt prill e maj.

Tabela 8. Interesi mesatar i ponderuar për depozitat në lekë (në %).

Muajt	3-mujore	6-mujore	12-mujore	Totali depozitave
Janar	6.91	7.52	7.73	7.17
Shkurt	6.84	7.61	7.79	7.13
Mars	6.90	7.53	7.77	7.17
Prill	6.87	7.41	7.68	7.11

Tabela 9. Yield-i mesatar i ponderuar për bonot e thesarit (në %).

Muajt	3-mujore	6-mujore	12-mujore
Janar	7.75	11.09	11.78
Shkurt	7.66	10.56	11.58
Mars	7.57	10.14	11.14
Prill	7.58	9.45	10.22
Maj	7.47	9.17	9.68

Siç vërehet nga të dhënat, *yield*-i i bonove të thesarit ka vazhduar të manifestojë një tendencë të pastër në rënie në të tri maturitetet përgjatë periudhës janar-mars 2001, tendencë e përforcuar edhe në dy muajt vijues. Përsa i përket normave të interesit të depozitave në tërësi mund të themi se ato kanë ardhur duke rënë, por tendenca nuk ka qenë e pastër. Ajo është luhatur nga një muaj në tjetrin për të arritur në 7.11 për qind në fund të muajit prill për totalin e depozitave. Ajo ç'ka ka rëndësi të theksohet është ngushtimi i vazhdueshëm i diferencës së normave të interesit për bonot e thesarit dhe për depozitat me afat në lekë. Ky ngushtim është më i theksuar në afatet më të gjata të maturimit (6 dhe 12-mujore) dhe pothuaj në nivel konstant për maturimin tremujor gjë që flet për një ecuri më normale të këtyre tregjeve.

Tabela 10: Yield-i ankandit për tremujorin e parë të vitit 2001 (në %).

Muajt	Yield-i
Janar	6.18
Shkurt	5.59
Mars	5.3

Të njëjtën tendencë ka manifestuar edhe *yield*-i mesatar i pranuar në ankandet e repove përkundrejt normës maksimale të pandryshuar prej 6.5 për qind, që ka ofruar Banka e Shqipërisë në këto ankande.

Ndërkohë, normat mesatare të interesit për kreditë e reja të akorduara në lekë vazhdojnë të jenë më të ngurta dhe të shfaqin lëvizje të çrregullta në secilin maturim.

Megjithatë, norma mesatare e rezultuar në fund të muajit prill prej 15.91 për qind është në nivelin më të ulët të katërmujorit.




Tabela 11. Interesi mesatar i kredive të dhëna gjatë periudhës janar-prill 2001.

	Mbi 3 vjet	1-3 vjet	6-12 muaj	Deri 6 muaj	Sistemi
Janar	15.09	22.87	15.22	23.58	16.72
Shkurt	16.25	20.69	19.71	18.92	20.05
Mars	15.58	22.19	16.10	23.22	17.62
Prill	13.51	15.50	22.27	15.08	15.91

Duhet theksuar se ecuritë e normave të interesit në përgjithësi, por sidomos ato të kredive, manifestojnë në masë të konsiderueshme deformimet e tregut bankar shqiptar dhe dominimin e tij. Megjithatë, rritja graduale e konkurrencës në të bën që pritshmëritë⁷ të jenë më optimiste si në drejtim të aktivitetit kredidhënës, ashtu edhe të depozitimit si edhe të normave përkatëse të interesit.

V.1. PRITSHMËRITË NË AKTIVITETIN KREDITUES.

Në përgjithësi, vlerësohet se aktiviteti kreditues për gjysmën e dytë të vitit 2001, do të manifestojë tendenca të theksuara për nivele më të larta si në monedhën e vendit ashtu edhe në monedha të huaja (rreth 74 për qind e të intervistuarve kanë këtë opinion). Kreditimi i bankave do të orientohet kryesisht në aktivitetin tregtar dhe atë industrial. Sektorë të tillë, si

transporti dhe sidomos bujqësia, edhe këtë vit, nuk do të sigurojnë financim nga ana e sistemit bankar. Zgjerimi i aktivitetit kreditues duket se do të rezultojë vetëm si pasojë e kërkesës së lartë që ekziston në tregun shqiptar për kredi, pasi pritet që normat e interesit të mos ndryshojnë (këtë opinion e përkrahin 50 dhe 62.8 për qind e të intervistuarve përkatësisht për normat e interesit në lekë dhe në valutë).

V.2. PRITSHMËRITË NË AKTIVITETIN DEPOZITUES.

⁷ Pritshmëritë për aktivitetin kreditues e depozitues vlerësohen në bazë të informacionit të siguruar prej intervistave që Banka e Shqipërisë organizon çdo gjashtë muaj, përkatësisht në muajt maj dhe nëntor me specialistët përkatës të bankave të nivelit të dytë.

Megjithëse normat e interesit të depozitave janë ulur në mënyrë të vazhdueshme, pritshmëria është që të vijojë rritja e depozitave në bankat tregtare si në lekë dhe në valutë për pjesën e mbetur të vitit (këtë opinion e përkrahin përkatësisht 66 dhe 56 për qind). Nga ana tjetër, ky fluks i shtuar i depozitave pritet të sigurohet nëpërmjet ndërprerjes së reduktimit të mëtejshëm të normave të interesit për depozitat. Me nivelin aktual të këtyre normave, sidomos të atyre në lekë, vlerësohet se është arritur pika e ekuilibrit dhe pritet që ai të mos ndryshojë për periudhën në vijim (60 për qind e të intervistuar japin këtë opinion). E njëjta tendencë vërehet edhe për interesat në valutë, megjithatë, ecuria e tyre do të varet më tepër nga lëvizjet e normave në tregjet ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë, pas një periudhe të gjatë 3.5-vjeçare zbutjeje të politikës monetare, ndjek me shumë kujdes zhvillimet, në përgjithësi, të tregjeve, për të përshtatur sa më mirë vendimet e saj me realitetin në tregjet e depozitave dhe të kreditit. Kështu, për t'i paraprirë zhvillimeve të ardhshme ajo mendon se ka ardhur koha për të adoptuar një qëndrim të ri pak më të ndryshëm se aktuali. Ky qëndrim duhet të kuptohet si mbarimi i periudhës së neutralitetit dhe fillimi i një politike më vëzhguese e vepruese në drejtim të normave të interesit. Megjithatë, duhet theksuar se kjo lëvizje është thjesht një lloj sinjali dhe nuk duhet konsideruar si një ndryshim i politikës monetare.